

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6874 E
martë, 18 prill 2023
Çmimi 0.40

Kosova pa Sistem Informativ Shëndetësor

FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", GANIMETE MUSLIU

QASJA E QEVERISË NDAJ DREJTUESVE TË UÇK-së NË HAGË, E TURPISHME



Deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ganimete Musliu, e ka akuzuar qeverinë Kurti për qasjen në raport me liderët e UÇK-së ndaj të cilëve ka filluar procesi gjyqësor në Hagë. Në këtë intervistë për "Epokën

e re", Musliu ka thënë se qasja e qeverisë ndaj Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit është e turpshme. "Qeveritarëve tanë nuk u bën zemra as t'i përmendin e lërë më të angazhohen institucionalisht rreth

asaj që po ndodh në këtë gjykatë të ndikuar politikisht", është shprehur Musliu. Ajo ka thënë se i gjithë procesi që ka filluar në Hagë është i montuar politikisht nga Serbia dhe bashkëpunëtorët e saj në Kosovë

OPINION

**KALOI GJYSMA E MANDATIT
QEVERISË DHE ASNJË SHENJË NUK
E BËRI NË EKONOMI QEVERIA E
"PUNËSIMIT DHE DREJTËSISË"** F. 6

Shkruan:
Avdullah HOTI



AKTUALE



**KRIKIU I KREMLINIT DËNOHET ME
25 VJET BURGIM** F. 2

**BE-ja KUNDËRSHTON NDALIMIN E
DRITHËRAVE TË UKRAINËS NGA
POLONIA DHE HUNGARIA** F. 2

EKONOMI



**MURATI FAJËSON LDK-në
QË QYTETARËT PO PAGUAJNË MË
SHTRENJTË VAJIN DHE BUKËN** F. 8

SPORT



**THAQI LARGOHET NGA DRITA, JOSA
FAVORIT PËR POZITËN E TRAJNERIT**

F. 10

**KRIMINELËT
SERBË DUHET
TË DALIN PËR
DREJTËSISË
PËR MASAKRAT
QË KRYEN NË
KOSOVË** | FAQE 3



**VAZHDON
INTERVISTIMI I
DËSHMITARIT TË
DYTË NË HAGË,
THOTË SE ËSHTË
ANËTAR I LDK-së** | FAQE 5



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Kritiku i Kremlinit dënohet me 25 vjet burgim

MOSKË, 17 PRILL - Gazetari Vladimir Kara-Murza, shtetas ruso-britanik dhe kritik i zëshëm i Kremlinit, u dënua me 25 vjet burgim për tradhti dhe vepra të tjera.

Gjykata e Qytetit të Moskës shpalli të hënën vendimin për akuzat të cilat vetë Kara-Murza i mohon.

Verdikti vjen pas më shumë se një viti prej se Kara-Murza është arrestuar nën akuzat për përhapje të "informacioneve të rreme" për forcat e armatosura të Rusisë.

Është ky një nga dënimet më të ashpra të një rusi i cili është shprehur kundër luftës së

Kremlinit në Ukrainë.

Qeveria britanike dënoi menjëherë verdiktin dhe dënimin, duke thënë se rasti kundër 41-vjeçarit, baba i tre fëmijëve, është "i motivuar politikisht". "Vladimir Kara-Murza ka dënuar me guxim pushtimin rus të Ukrainës për atë që është - një shkelje flagrante e ligjit ndërkombëtar dhe Kartës së OKB-së", thuhet në deklaratën e Qeverisë britanike. "Mungesa e angazhimit të Rusisë për t'i mbrojtur të drejtat themelore të njeriut, duke përfshirë lirinë e shprehjes, është alarmante", thuhet në deklaratë.



Kara-Murza, kundërshtar i zëshëm i qeverisë aktuale ruse, tha se është burgosur për pikëpamjet e tij politike që janë

kundër luftës në Ukrainë dhe kundër "diktaturës së presidentit rus Vladimir Putin". "Jo vetëm që nuk pendohem për

asnjë nga këto, por jam krenar për të gjitha", tha ai, duke shtuar se mezi pret një ditë "kur ata që e ndezën këtë luftë, dhe jo ata që u përpoqën ta ndalin atë, të jenë të njohur si kriminelë".

Rusia ka miratuar një ligj që kriminalizon përhapjen e "informacionit të rremë" për ushtrinë e saj, menjëherë pasi ka nisur pushtimin në shkallë të gjerë të Ukrainës, më 24 shkurt të vitit 2022.

Kara-Murza është i fundit në mesin e disa aktivistëve të opozitës, reporterëve dhe të tjerëve që janë arrestuar dhe ndjekur penalisht në bazë të këtij ligji.

Ministrja gjermane: Evropa duhet ta mbrojë rregullin global



BERLIN, 17 PRILL - Evropa jo vetëm që duhet ta mbrojë paqen e saj, por duhet të veprojë si mbikëqyrëse në gjithë botën, ka thënë ministrja e Jashtme gjermane, Annalena Baerbock, të hënën, pas bisedimeve që ka pasur për Kinën, me homologët e grupit të shtatë shteteve më të industrializuara në botë (G7).

Komentet e saj kanë ardhur pasi presidenti francez Emmanuel Macron ka nxitur polemika, meqë në vizitën e tij të fundit në Pekin ka thënë se Evropa duhet

t'i shmangë "krizat që nuk janë tonat".

Evropianët "nuk duhet të izolojnë në territorin tonë. Ne nuk duhet ta kufizojmë veten për ta mbrojtur paqen evropiane, sepse është nën sulm", ka thënë Baerbock në një konferencë për media në Japoni, ku është mbajtur takimi i diplomatëve të G7-s. "Ne duhet të veprojmë në mënyrë sovraane dhe të pavarur, me qasje të gjerë në botë, sidomos kur të tjerët veprojnë në dëmin tonë, ose në

dëmin e të tjerëve", ka shtuar ajo.

Baerbock, po ashtu, ka paralajmëruar se Kina "dëshiron t'i zëvendësojë rregullat aktuale ndërkombëtare, me rregullat e saj", duke përmendur qasjen agresive të Pekinit në ujërat e kontestuar, siç është ndërtimi i ishujve artificialë.

Veprime të tilla "rrezikojnë rregullin ndërkombëtar në Indo-Paqësor. E gjitha kjo e bën të qartë pse është aq e rëndësishme, sidomos në këto

kohë, që shtetet, të cilat besojnë në ligjin ndërkombëtar, të qëndrojnë bashkë".

Përgjatë vizitës së saj të fundit në Pekin, javën e kaluar, Baerbock ka paralajmëruar për "skenar të tmerrshëm" në rast të "përshkallëzimit ushtarak" në Ngushticën e Tajvanit.

Tajvani është ishull që vetëqeveriset, por të cilin e pretendon Pekini.

Autoritetet kineze besojnë se do ta kontrollojnë këtë ishull dikur, qoftë edhe me forcë.

BE-ja kundërshton ndalimin e drithërave të Ukrainës nga Polonia dhe Hungaria

BRUKSEL, 17 PRILL - Komisioni Evropian i kundërshtoi ndalesat e vendosura nga Polonia dhe Hungaria mbi importet e grurit të Ukrainës. Dy vendet thanë se masat janë të nevojshme për t'i mbrojtur sektorët e tyre bujqësorë nga importet e lira.

Ndalesat vlejnë për drithërat, produktet e qumështit, sheqerin, frutat, perimet dhe mishin, dhe do të jenë në fuqi deri në fund të qershorit.

Komisioni tha se nuk u takon shteteve anëtare që individualisht

të bëjnë politika tregtare.

Ai tha se veprimet e njëanshme nuk do të tolerohen, por nuk specifikoi se çfarë masash do të marrë kundër Polonisë dhe Hungarisë. "Në kohë të tilla sfiduese është thelbësore që të koordinohen dhe të përafrohen të gjitha vendimet brenda BE-së", tha një zëdhënës i këtij institucioni.

Shumica e grurit ukrainas eksportohet nëpërmjet Detit të Zi, por pushtimi rus vitin e kaluar i ndërpreu rrugët e eksportit dhe bëri që sasi të mëdha të drithërave

të përfundojnë në Evropën qendrore.

Një marrëveshje me Rusinë, e ndërmjetësuar nga OKB-ja dhe Turqia, i lejon Ukrainës t'i vazhdojë eksportet përmes detit, por Ukraina thotë se Rusia e ngadalëson procesin me anë të inspektimeve.

Polonia dhe Hungaria morën vendimin në fundjavë, pas ankesave nga fermerët vendas, të cilët thanë se po dëmtohen nga drithërat ukrainase që shiten më lirë.



Mellburni kalon Sidnejin si qyteti më i madh i Australisë



MELLBURN, 17 PRILL - Mellburni ka tejkaluar Sidnejin si qyteti më i populluar i Australisë për herë të parë qysh në shekullin 19. Sidneji e ka mbajtur me krenari këtë titull për më shumë se 100 vjet. Por, me rritjen e shpejtë të popullsisë në periferi të Mellburnit, kufijtë e qytetit janë zgjeruar, duke përfshirë edhe zonën Mellton.

Shifrat e fundit të qeverisë australiane tregojnë se popullsia e Mellburnit përbëhet prej 4.875.400 banorësh - 18.700 më shumë se ajo e Sidnejit.

Rritja e shpejtë e Mellburnit lidhet kryesisht me migrimin ndërkombëtar, tha për BBC-në demografja e Universitetit Kombëtar Australian, Liz Allen. Ndryshe nga Sidneji,

Mellburni e mirëpret diversitetin, tha ajo.

Kjo nuk është hera e parë që Mellburni mban titullin e qytetit më të madh të Australisë.

Si rezultat i lëvizjeve të mëdha të popullsisë në fund të shekullit 19, Mellburni është rritur me shpejtësi dhe ka tejkaluar Sidnejin deri në vitin 1905.

PËRKUJTOHET 24-VJETORI I MASAKRËS SË POKLEKUT DHE ÇIKATOVËS

Kriminelët serbë duhet të dalin para drejtësisë për masakrat që kryen në Kosovë

Presidentja Vjosa Osmani, kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, dhe kryeministri Albin Kurti, kanë nderuar të hënën të rënët në masakrën e Poklekut e të Çikatovës, të kryer nga shteti i Serbisë 24 vjet më parë. Homazhe në Poklek dhe Çikatovë ka bërë edhe lideri i PDK-së, Memli Krasniqi. Vetëm në Poklek dhe Çikatovë ushtria dhe policia serbe kanë vrarë dhe masakruar mbi 77 civilë shqiptarë, duke filluar nga foshnja gjashtëmuajshe e deri te pleqtë. Shumicën e kufomave i kanë djegur

EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 17 PRILL - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, së bashku me Zotërinë e Parë, Prindon Sadriu, me kryetarin e Kuvendit, Glauk Konjufca dhe kryeministrin Albin Kurti, kanë bërë homazhe në kompleksin memorial në Poklek. Presidentja Osmani ka thënë se sot është një prej ditëve më të trishtuara të përkujtimit të viktimave të luftës së fundit në Kosovë. "Këtu në Poklek ka ngjarë një Holokaust i vërtetë. Siç edhe e dini, diku 54 anëtarë të familjeve Muqolli, Elshani dhe të tjerë, kryesisht gra dhe fëmijë, në fakt shumica dërrmuese prej tyre fëmijë, fillimisht janë ekzekutuar, pastaj janë djegur dy herë në mënyrë që edhe të eliminohen gjurmët e këtij krimi të llahtarshëm të forcave serbe në Kosovë", ka theksuar Osmani. Presidentja ka thënë se kjo është një ndër dëshmitë më të fuqishme se regjimi serb kishte për qëllim shfarosjen e popullit tonë dhe kishte për qëllim që asnjë shqiptar të

mos mbetet në tokën e Kosovës. "Edhe kjo masakër, ashtu sikurse edhe ajo në Çikatovë që do të shkojmë pas pak, dëshmojnë egërsinë e këtij regjimi dhe njëkohësisht janë edhe dëshmi e dhimbshme se si akoma nuk ka drejtësi për të gjitha këto viktima të popullit tonë. Personat që e kanë urdhëruar masakrën në Poklek dihen me emër dhe mbiemër, për ta janë mbledhur prova por, për fat të keq, regjimi i sotëm në Serbi nuk po vendos drejtësi dhe ata që urdhëruan këto masakra po shpërblehen më pozicione edhe më të larta në policinë e Serbisë. Kjo tregon që ajo mendësi që ka ekzistuar në vitet '90 në Serbi ende vazhdon edhe sot. Pra mendësia e mohimit të gjenocidit, mendësia që eliminon çdo mundësi për vënien para drejtësisë të kriminelëve që kanë kryer këto masakra dhe mendësia shkatërrimtare e cila ka çuar drejt luftërave në ish-Jugosllavi. Ne i përkujtojmë të gjitha këto viktima, në veçanti fëmijët e vegjël, përfshirë edhe foshnjën gjashtëmuajshe Lirie Muqolli, emri i së cilës edhe e dëshmon më së miri sakrificën e



jashtëzakonshme që ka bërë populli i Kosovës për liri", ka theksuar presidentja. Më pas krerët shtetërorë kanë vizituar edhe shtëpinë e familjes Muqolli. Ndërkaq, më pas Osmani, Konjufca dhe Kurti kanë bërë homazhe edhe në Çikatovë të Vjetër. Presidentja Osmani tha se 17 prilli është një prej ditëve më të trishtuara për popullin shqiptar, është një ditë kur i kemi humbur njerëzit tanë anekënd Kosovës dhe edhe Çikatova e Vjetër është një dëshmi më shumë e krimeve të llahtarshme që Serbia ka kryer kundër nesh. "Edhe për këtë masakër të 17 prillit në Çikatovë, që nuk ka qenë e vetmja, në Çikatovë ka shumë të vrarë në ditë të tjera përgjatë viteve '98 e '99, por edhe kjo masakër tregon që

egërsia e pushtetit serb ka qenë ndaj të gjithëve, pra nuk është kursyer askush, as pleqtë, as fëmijët, as gratë dhe janë pushkatuar në raste të caktuara dhe këtu janë djegur pa asnjë mëshirë. Ajo çka kërkojmë edhe sot në këtë përvjetor është drejtësi për të gjitha viktimat", ka shtuar Osmani.

Masakrat në Kosovë të viteve 1998-1999 Konjufca i cilësoi akte të gjenocidit të shtetit të Serbisë mbi popullatën civile të Kosovës. Kreu i Kuvendit tha se të gjitha masakrat që i ka bërë Serbia në Kosovë tregojnë qëllimin e vërtetë që ky shtet ka pasur e që ishte shfarosja dhe zhdukja e kombit tonë, meqenëse nuk janë kursyer as fëmijët. Kjo, shtoi Konjufca, tregon që të gjithë janë vrarë vetëm pse ishin shqiptarë. "Vetëm në Poklek dhe Çikatovë ushtria dhe policia serbe kanë vrarë e masakruar mbi 77 civilë shqiptarë, duke filluar nga foshnja gjashtëmuajshe deri te pleqtë e shtyrë në moshë. Shumicën e kufomave i kanë djegur", është shprehur Konjufca. Ai ka thënë se dita e sotme është ditë e dhimbjes, po ashtu edhe e krenarisë, për arsye se falë këtij gjaku të derdhur dhe sakrificave të panumërta që kemi bërë si popull dhe si shoqëri, jemi çliruar dhe ka ardhur liria për popullin e Kosovës. Konjufca tha se Serbia ende nuk është dënuar si shtet për krimet dhe gjenocidin që ka kryer në Ballkan gjatë viteve '90. Ai ka shtuar se gjeneralët e ushtrisë dhe oficerët e nivelit të lartë jo që nuk janë dënuar, por kanë bërë karrierë të lirë ushtarake e policore në Serbi. Konjufca theksoi se përcaktimi që ka shteti i Serbisë po shihet

edhe sot e kësaj dite.

Duke folur për masakrën e 17 prillit të vitit 1999, kryeministri Kurti tha se në Çikatovë të Vjetër të Drenicës "jo vetëm që u vranë shqiptarët që jetonin në tokën e tyre dhe dëshironin veçse liri dhe paqe por, gjithashtu, edhe kufomat e tyre u rrëmbyen dhe u dërguan në Serbi në varreza masive, në pesë varreza masive gjithsej mbi 950 shqiptarë".

Kurti ka thënë se ai, Osmani dhe Konjufca bëjnë thirrje edhe njëherë që Prokuroria e Shtetit, sistemi i drejtësisë në vendin tonë, të jetë shumë më aktiv sepse, sipas tij, është koha e fundit të sjellin drejtësi për viktimat dhe dënim për kriminelët.

Ndërkaq lideri i PDK-së, Memli Krasniqi, ka theksuar se masakra e Poklekut në Drenas, 24 vjet më parë, shpërfaq në formën më të rëndë terrorin që regjimi gjenocidal serb ka kryer mbi popullatën civile shqiptare. "Populli dhe shteti i Kosovës asnjëherë nuk do t'i harrojnë këto krime derisa ato të zbardhen dhe përgjegjësit ta marrin dënimin e merituar", është shprehur Krasniqi.

Ai bërë homazhe edhe në Çikatovë të Vjetër. "Më 17 prill të vitit 1999 ofensivën për spastrim etnik përmes vrasjeve brutale të civilëve të pafajshëm në Drenicë, forcat kriminale serbe e vazhduan edhe në Çikatovë të Vjetër të Drenasit. Liria dhe pavarësia e Kosovës nuk do të jenë asnjëherë të plota pa dalë para drejtësisë kriminelët serbë të cilët kryen këto masakra. Edhe sot ndajmë dhembjen me familjet e martirëve të cilat vazhdojnë të jetojnë me plagë të hapura. Lavdi të gjithë të rënëve për lirinë e Kosovës!"





FLET PËR "EPOKËN E RE", GANIMETE MUSLIU

Qasja e qeverisë ndaj drejtuesve të UÇK-së në Hagë, e turpshme

Deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ganimete Musliu, e ka akuzuar qeverinë Kurti për qasjen në raport me liderët e UÇK-së ndaj të cilëve ka filluar procesi gjyqësor në Hagë. Në këtë intervistë për "Epokën e re", Musliu ka thënë se qasja e qeverisë ndaj Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit është e turpshme. "Qeveritarëve tanë nuk u bën zemra as t'i përmendin e lërë më të angazhohen institucionalisht rreth asaj që po ndodh në këtë gjykatë të ndikuar politikisht", është shprehur Musliu. Ajo ka thënë se i gjithë procesi që ka filluar në Hagë është i montuar politikisht nga Serbia dhe bashkëpunëtorët e saj në Kosovë

dispozicion të Albin Kurtit për të shkatërruar çdo gjë të arritur deri më tani në mënyrë që të ketë mundësi më të mëdha për të ndërtuar një strukturë të nënshtruar që do ta kontrollonte më lehtë. Thjesht, kemi të bëjmë me një qeveri të udhëhequr nga një diktator i vogël", ka thënë deputetja Musliu.

Krahas kësaj, Musliu e ka akuzuar qeverinë edhe për qasjen në raport me liderët e UÇK-së, Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Rexhep Selimin dhe Jakup Krasniqin, ndaj të cilëve ka filluar procesi gjyqësor në Hagë. "Qasja ndaj eprorëve të Ushtrisë Çlirimtare dhe ndaj procesit të Hagës në përgjithësi është turpi më i madh i saj. Kjo qeveri nuk ka treguar as respektin minimal njerëzor e mos të flasim për obligimin institucional të cilin as që e ka konsideruar fare. Qeveritarëve tanë nuk u bën zemra as t'i përmendin e lërë më të angazhohen institucionalisht rreth asaj që po ndodh në këtë gjykatë të ndikuar politikisht", është shprehur Musliu.

Musliu, e cila ka qenë kundër themelimit të Gjykatës Speciale,

ka thënë se i gjithë procesi që ka filluar në Hagë është një proces i montuar politikisht nga Serbia dhe bashkëpunëtorët e saj në Kosovë. "E them me bindje të plotë se drejtësia gjithmonë do të triumfojë, edhe atëherë kur qëndron mbi sakrificat të mëdha, edhe atëherë kur qëndron mbi sfida të rënda, në fund drejtësia do të dalë në pah dhe ata që kanë kontribuar në ngritjen e kësaj gjykate do të mbeten në anën e errët të historisë sonë më të lavdishme", ka thënë Musliu.

"Epoka e re": Znj. Musliu, kanë mbetur pak ditë nga mbajtja e zgjedhjeve në veri të Kosovës. Duke i parë zhvillimet në veri, fillimisht a mund të na jepni një vlerësim të përgjithshëm për situatën e sigurisë në Kosovë, veçmas në katër komunat veriore?

Musliu: E gjithë situata e krijuar në veri të vendit është si rezultat i vendimeve të pamatura të një kryeministri i cili politikën e bazon në polarizim dhe në konfuzion. Gjendja në të cilën Albin Kurti e ka manovruar Kosovën është në disfavor politik

dhe përtej kësaj është një fushë e minuar sa i përket sigurisë dhe sovranitetit të vendit tonë. Zgjedhjet që pritet të mbahen po përcillen me një ndjenjë pasigurie dhe kjo ndjenjë nuk është ndjenjë fantome, por diçka reale sepse edhe në rast se zgjedhjet mbahen, kjo nuk do të thotë se gjendja nuk do të mbetet e tensionuar. Pas shtyrjes disamujore të këtyre zgjedhjeve, pas dështimit të përdorimit të targave RKS, pas bojkotit të institucioneve nga zyrtarët e komunitetit serb, sot pyetja që duhet shtruar është nëse kokëfortësia e Albin Kurtit ishte një veprim prej një burrështetasi të zgjuar dhe të matur. A është e pranueshme për ne dhe për të ardhmen e këtij vendi një sjellje e cila e ka çuar situatën në një tensionim kaq të madh. Shpresoj që zgjedhjet të shkojnë mirë, të pranohen si legjitime dhe që veriu i vendit të mos rrëshqasë në drejtim të një konflikti të ngrirë apo edhe më keq.

"Epoka e re": Qeveria e drejtuar nga Albin Kurti këto ditë ka bërë dy vjet prej që është në pushtet.

EPOKA E RE

Lirim GECI

PRISHTINË, 17 PRILL - Deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ganimete Musliu, e ka kritikuar ashpër qeverinë Kurti në raport me politikën e brendshme dhe të jashtme. Ajo ka thënë se kjo qeveri duhet të ndihet e turpëruar për mënyrën se si është duke qeverisur Kosovën.

Musliu në këtë intervistë për "Epokën e re" e ka quajtur të rrezikshme për Kosovën treshen kryesore institucionale,

presidenten Vjosa Osmani, kryeparlamentarin Glauk Konjufca dhe kryeministrin Albin Kurti. Madje Musliu ka thënë se Osmani dhe Konjufca janë vetëm pjesë dekorative e marrëzisë së kryeministrit Albin Kurti të cilin e ka quajtur diktator të vogël. "Një trinom i rrezikshëm për rrugën e Kosovës drejt përparimit dhe inkuadrimit, edhe pse Osmani dhe Konjufca po dëshmojnë se janë vetëm pjesë dekorative e marrëzisë së Albin Kurtit. Që të tre këta, por edhe i gjithë kabineti qeveritar, janë vënë në

Vazhdon intervistimi i dëshmitarit të dytë në Hagë, thotë se është anëtar i LDK-së

HAGË, 17 PRILL - Në Hagë po vazhdon procesi gjyqësor ndaj ish-krerëve të UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi e Rexhep Selimi. Në Dhomat e Specializuara në Hagë ka filluar të dëgjohet dëshmitari i dytë i Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS) i cili ka deklaruar se është anëtar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Ai ka folur për daljen e parë publike të UÇK-së dhe paraqitjen e Mujë Krasniqit, Daut Haradinajt dhe Rexhep Selimit. Për këtë të fundit, ka thënë se kishte adresim më të rreptë dhe, sipas tij, kishte mesazh për LDK-në. I pyetur nga ZPS-ja para kalimit në seancë private, dëshmitari tha se është bërë anëtar në LDK pasi që ajo, sipas tij, kishte pasur një program për shtet dhe për pavarësinë e Kosovës dhe ka qenë kundërshtarë e sistemit

të ish-Jugosllavisë. "Anëtar i LDK-së jam bërë sepse LDK-ja ka pasur program për shtet dhe për pavarësinë e Kosovës nga Serbia", deklaroi dëshmitari.

Pasi një pjesë e seancës është zhvilluar privatisht, dëshmitari ka vazhduar të përgjigjet në pyetjet e prokurorit rreth UÇK-së. Më tutje, dëshmitari ka thënë se ka marrë pjesë në varrimin e mësuesit Halit Geci në Llaushë, në nëntor të vitit 1997, dhe ka shtuar se atë ditë është bërë edhe dalja publike e UÇK-së.

Prokuroi James Pace e ka pyetur rreth personave të cilët i ishin drejtuar masës atë ditë.

Dëshmitari ka thënë se atë ditë kishin folur Mujë Krasniqi, Rexhep Selimi dhe Daut Haradinaj.

Ai ka thënë se Mujë Krasniqi kishte bërë thirrje për mbështetjen e luftës së UÇK-së si dhe për lirinë e Kosovës.



Intervistimi i dëshmitarit të dytë në rastin ndaj ish-krerëve të UÇK-së ka vazhduar shumicën e kohës në seancë të mbyllur e herë pas herë në seancë të hapur.

Gjykatësi Charles Smith ka njoftuar se intervistimi i tij do

të zgjasë pesë ditë.

Trupi gjyqësor ka miratuar kërkesën e mbrojtjes të ish-presidentit Hashim Thaçi, të mbështetur nga mbrojtja e Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, duke zgatur afatin për përgjigje nga ana e

mbrojtjes deri më 24 prill 2023, ndaj mocionit të Prokurorisë për pranimin e deklaratave të të akuzuarve. Ndërkaq të hënën dëshminë e saj e ka përfunduar dëshmitarja e parë me kodin W04474 në rastin ndaj Thaçit dhe të tjerëve.

Cili është vlerësimi juaj për punën e kësaj qeverie?

Musliu: Çfarë vlerësimi mund të kem. Nuk e vlerësoj fare. Përgjatë dy vjetëve të fundit kemi parë një shfaqje të dobët teatrale të një trupe të paaftë. Asnjë premtim, qoftë edhe atë më të voglin, nuk e kanë realizuar, përkundrazi çdo segment i shtetit ka pësuar dëme të mëdha sepse qeverisja e tyre është fokusuar në ngarkim-shkarkime dhe në një trysni të paparë mbi administratën publike. Shumë pozita kyçe kanë mbetur bosh, në shumë pozita të tjera kyçe janë vendosur persona jo adekuatë, sektori privat është sulmuar rëndë, korrupsioni dhe familjarizmi kanë shënuar rritje, zhvillim ekonomik nuk kemi, reforma nuk kemi, por kemi rritje çmimesh dhe ulje pagash. Kemi ikje masive të popullit sepse qeverinë që ata zgjedhën, pikë kryesore të programit kishte shpresën e jo mirëqenien e tyre. Përveç dështimeve faktike, ne kemi një qeveri shumë të papërgjegjshme dhe arrogante e cila edhe në dy vitet e ardhshme nuk premtonte ndonjë përmirësim minimal. Pra, i vetmi premtim që kjo qeveri ka realizuar është ai për ndryshim, por ndryshimi erdhi për keq dhe shpresoj që qytetarët e këtij vendi e kanë kuptuar se shteti nuk bëhet me "hajt ta provojmë". Me "ne ishte një herë" dhe me "ne ua rikthejmë shpresat" fillojnë dhe mbarojnë përrallat, por kurrë nuk ndërtohet një shtet stabil dhe i konsoliduar. Albin Kurti erdhi në pushtet si demagog dhe i tillë do të largohet, vetëm se tani me barrën e dështimit mbi supë.

"Epoka e re": A ka ndonjë fushë ku mund të krenohet qeveria Kurti, brenda ose jashtë?

Musliu: Jo! Për fatin tonë të keq,



nuk ka asnjë fushë ku kjo qeveri mund të krenohet. Përkundrazi, duhet të turpërohet sa i përket politikës së brendshme dhe asaj të jashtme.

"Epoka e re": Në këtë kontekst, çfarë vlerësimi keni për drejtuesit kryesorë të shtetit: Vjosa Osmanin, Glauk Konjufcën dhe Albin Kurtin?

Musliu: Një trinom i rrezikshëm për rrugën e Kosovës drejt përparimit dhe inkuadrimit edhe pse Osmani dhe Konjufca po dëshmojnë se janë vetëm pjesë dekorative e marrëzisë së Albin Kurtit. Që të tre këta, por edhe i gjithë kabineti qeveritar, janë vënë në dispozicion të Albin Kurtit për të shkatërruar çdo gjë të arritur deri më tani në mënyrë që të ketë mundësi më të mëdha për të ndërthtur një strukturë të nënshtruar që do ta kontrollonte

më lehtë. Thjesht, kemi të bëjmë me një qeveri të udhëhequr nga një diktator i vogël.

"Epoka e re": Znj. Musliu, personalisht keni qenë kritike për punën e qeverisë, por si e vlerësoni rolin e opozitës në këto dy vjet?

Musliu: Vitin e parë të qeverisjes së Albin Kurtit e gjithë opozita ka qenë konstruktive dhe e gatshme për ta ndihmuar. Meqenëse jo vetëm vendi ynë, por i gjithë globi po kalonte një periudhë të vështirë, kjo qasje e opozitës ishte qasje e duhur sepse përtej të gjithave kishim të bënim edhe me një kabinet qeveritar krejtësisht të papërgatitur. Konstruktiviteti i opozitës nuk u respektua aspak sepse të paditurit nuk dinë të respektojnë, sepse të paditurit kanë frikë edhe nga hijet e veta.

Në vitin e dytë mendoj se opozita do të duhej të ishte shumë më aktive dhe më e ashpër. Për fat të keq, Kosova sot ka një qeveri të dëmshme përballë një opozite të plogësht. Por kjo nuk do të thotë të vazhdohet kështu. Përballë një qeverie e cila nuk rezymon rreth gabimeve të veta duhet të vihemi të gjithë, ne si opozitë parlamentare, mediet, shoqëria civile dhe i gjithë populli. Kështu ndikojmë që kjo qeveri dhe çdo qeveri tjetër që vjen pas saj ta kuptojë se qeverisje do të thotë t'i shërbesh të mirës së përgjithshme e jo të bësh të fortin dhe të paprekshmin.

"Epoka e re": Mendoni se PDK-ja ka qenë në nivel të detyrës gjatë kësaj periudhe kohore?

Musliu: Për mendimin tim askush nuk ka qenë në nivel të detyrës dhe duke qenë kështu më duhet të them se për këto dy vjet e më shumë është sulmuar PDK-ja se qeveria e Albin Kurtit. PDK-ja ka kaluar disa sfida shumë të rënda dhe ka arritur t'i kalojë me shumë sukses zgjedhjet lokale. Kjo lë të kuptohet se PDK-ja është partia më e konsoliduar në vend dhe se ka potencial për ta bërë jo vetëm opozitën, por edhe për t'u rikthyer fuqishëm në zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Jam e bindur se PDK-ja do ta forcojë opozitarizmin dhe do ta vërtetojë se është partia e vetme që këtij vendi i garanton stabilitet dhe mirëqenien për qytetarët. Qytetarët e Kosovës duhet ta dinë se PDK-ja nuk është parti që krekoset vetëm me arritjet që ka sjellë, por është një parti që punon pa ndal për ta përmirësuar cilësinë e saj qeverisëse.

"Epoka e re": Znj. Musliu,

tashmë në Hagë ka filluar procesi gjyqësor ndaj Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit. Si jeni duke e parë krejt këtë proces dhe cilat janë pritjet tuaja?

Musliu: I gjithë procesi që ka filluar në Hagë është një proces i montuar politikisht nga Serbia dhe bashkëpunëtorët e saj në Kosovë. Se si do të ecë, unë nuk mund ta them, por ajo që e them me bindje të plotë është se drejtësia gjithmonë do të triumfojë, edhe atëherë kur qëndron mbi sakrificat të mëdha, edhe atëherë kur qëndron mbi sfida të rënda, në fund drejtësia do të dalë në pah dhe ata që kanë kontribuar për ngritjen e kësaj gjykate do të mbesin në anën e errët të historisë sonë më të lavdishme.

"Epoka e re": Kur jemi te procesi gjyqësor në Hagë, sa ka qenë dhe sa është Qeveria e Kosovës në nivelin e detyrës për t'i mbështetur drejtuesit e UÇK-së?

Musliu: Kjo qeveri nuk mund të krenohet me ndonjë veprim, por qasja ndaj eprorëve të Ushtrisë Çlirimtare dhe ndaj procesit të Hagës në përgjithësi është turpi më i madh i saj. Kjo qeveri nuk ka treguar as respektin minimal njerëzor e mos të flasim për obligimin institucional të cilin as që e ka konsideruar fare. Qeveritarëve tanë nuk u bën zemra as t'i përmendin e lërë më të angazhohen institucionalisht rreth asaj që po ndodh në këtë gjykatë të ndikuar politikisht. Po e përsëris edhe një herë, kemi të bëjmë me një qeveri që ka dështuar në çdo segment. Për të mirën e të gjithëve, uroj që të reflektojnë dhe të ndërrojnë qasjen e tyre sepse nuk jam e sigurt nëse ky popull do të vegjetojë edhe në dy vitet e ardhshme.

Kosova pa Sistem Informativ Shëndetësor



PRISHTINË, 17 PRILL - Me plot dokumente mjekësore nga kontrollet e ndryshme që kishte bërë më herët te mjekët në ortopedi, otorinolaringologji e endokrinologji, Luljeta Zeqiri po priste në radhë që të kryente një kontroll në ambulancën qendrore të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) në Prishtinë. Ajo, sikurse shumë pacientë të tjerë, ishte detyruar t'i merrte me vete të gjitha dokumentet të cilat pasqyrojnë shëndetin e përgjithshëm të saj, pasi në Kosovë nuk funksionon Sistemi Informativ Shëndetësor (SISH). "Për mua bartja e këtyre dokumenteve është shumë e lodhshme. Edhe tash kam një problem tjetër shëndetësor dhe më duhet t'i tregoj mjekut për të kaluarën...", rrëfen Zeqiri për "Radion Evropa e Lirë". Ajo thotë se në mungesë të sistemit i ka të ruajtura në shtëpi të gjitha raportet dhe dokumentet e vizitave mjekësore, të bëra në pesë vjetët e fundit.

Njohësi i politikave shëndetësore, specialisti Valdet Hashani, thotë se mungesa e një databaze për pacientë paraqet pengesë të madhe në punë. Hashani punon në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Prishtinë dhe thotë se i merr shumë kohë për ta kuptuar historikun shëndetësor të një pacienti. "Nëse do të kishte një sistem, [pacienti] paraqitet te mjeku, caktohet termini... dhe ti e di saktë se sa pacientë do t'i kesh. Ky është një lehtësim për mjekun. Unë sot [29.03.2023] kam pasur 68 pacientë - 30 prej tyre kanë qenë

për herë të parë dhe nuk kam asnjë informacion për ta. Kështu, duhet të hysh dhe ta marrësh anamnezën, historinë familjare. Për mjekun është rraskapitëse, është shumë e lodhshme. Po të kishte Sistem të Informimit Shëndetësor, me një klik, mjeku familjar do t'i kishte të gjitha të dhënat e pacientit", thotë Hashani për "Radion Evropa e Lirë".

Sistemi Informativ Shëndetësor bën gjenerimin, përpilimin, analizimin, komunikimin dhe përdorimin e të dhënave për sektorin publik dhe privat shëndetësor. Për ta përmirësuar shërbimin shëndetësor ndaj qytetarëve të Kosovës, Ministria e Shëndetësisë (MSh) në vitin 2011 ka provuar fillimin e zbatimit të këtij sistemi në tri faza.

Dy fazat e para planifikohej ta përfshinin pilotimin dhe implementimin e sistemit në 30 përqind të territorit të vendit dhe vlerësimin e pilotimit në fund të vitit 2014, ndërsa faza e tretë përfshinte implementimin e sistemit në gjithë territorin e vendit, me synim që të realizohej deri në vitin 2020. Mirëpo as tash në vitin 2023 sistemi në fjalë nuk është realizuar.

Cilat janë arsyet?

Zyra Kombëtare e Auditimit në Kosovë (ZKA) ka kryer një auditim për periudhën 2010-2017 lidhur me zbatimin e Sistemit Informativ Shëndetësor si projekt i Ministrisë së Shëndetësisë. Sipas këtij auditimi, Ministria e Shëndetësisë

nuk ka arritur ta realizojë planin për këtë sistem.

Në një deklaratë me shkrim dërguar "Radion Evropa e Lirë" më 29 mars 2023, Zyra Kombëtare e Auditimit përmendi disa arsye të dështimit të sistemit: "MSh-ja ende nuk i ka funksionalizuar kartelat profesionale shëndetësore të cilat nevojiten për identifikimin dhe autorizimin e profesionistëve të kujdesit shëndetësor". Sipas ZKA-së, shpërndarja e infrastrukturës fizike ka munguar në të gjitha institucionet shëndetësore, në të cilat ka qenë e paraparë dhe, po ashtu, sipas saj, nuk ka pasur riorganizim të të dhënave ekzistuese, me qëllim që ato të futeshin në sistemin e ri.

Çfarë thonë në Ministrinë e Shëndetësisë?

Ministri i Shëndetësisë në Qeverinë e Kosovës, Arben Vitia, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se ky sistem është i domosdoshëm për shëndetësinë në Kosovë, për funksionalizimin e sigurimeve shëndetësore dhe për vetë sistemin shëndetësor. Ai thotë se nuk di shumë detaje për mosrealizimin e projektit, por shton se ministria që ai aktualisht drejton është duke punuar në këtë drejtim. Sipas tij, pas pak kohe do të mund të shihen edhe rezultatet. "Tash, për të mos pasur asnjë dyshim në hapat e vazhdueshëm, bashkë me partnerët tanë ndërkombëtarë, është duke u bërë një studim fizibiliteti i thuktë, i cili do të përfundojë në muajin qershor dhe

i cili do të na tregojë të gjitha rekomandimet dhe hapat konkretë se si do t'i qasemi ndërtimit të këtij Sistemi Informativ Shëndetësor, që të mos dështojmë edhe një herë. Me përfundimin e këtij studimi të fizibilitetit, nga qershori, menjëherë dhe paralelisht, jemi duke i bërë të gjithë hapat që të përgatitemi që, pas rekomandimeve, të fillojmë implementimin e këtij sistemi shumë të rëndësishëm", thotë Vitia. Nga ana tjetër, ish-ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, tash nënkryetar i Komisionit Parlamentar për Shëndetësi në Kuvendin e Kosovës, thotë se mundësi buxhetore dhe investime në këtë rrafsh ka pasur, por se rezultatet kanë munguar. "Kanë ndodhur investime milionëshe, por që tre vjet duke u shtyrë me të njëjtat interesa njerëzit, të cilët e udhëheqin pjesën administrative të MSh-së dhe që kanë ndikim te ministri ose te politikat e ministrit. Nuk kanë lëvizur asnjë milimetër - të them - për funksionimin e këtij sistemi", thotë Zemaj për "Radion Evropa e Lirë", por nuk specifikon më shumë. Ai thotë se gjatë kohës sa ai ka qenë ministër ka qenë kohë pandemie dhe se nuk është marrë me investime kapitale. Sipas tij, me mungesën e këtij sistemi jeta e pacientëve vështirësohet dhe keqpërdorimet janë më të mëdha.

Humolli nga OBSH-ja: Kosova duhet ta ketë SISH-in

Isme Humolli, zyrtare profesionale e emergjencave në

Organizatën Botërore të Shëndetësisë në Kosovë, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se Sistemi Informativ Shëndetësor kërkon shumë kohë për të qenë gjithëpërfshirës. Sipas saj, secili shtet është i obliguar ta ketë Sistemin Informativ Shëndetësor. "Sistemi i Informimit Shëndetësor është i domosdoshëm dhe duhet ta ketë edhe Kosova. Kosova ka pasur të dhëna edhe më herët, por tash është koha të bëhet kompaktibil me tërë sistemin në Evropë dhe botë, sidomos me Evropën", konsideron Humolli.

Investimet për SISH-in

Në vitin 2010 Ministria e Shëndetësisë e Kosovës ka hartuar dhe aprovuar strategjinë për Sistemin Informativ Shëndetësor në Kosovë (2010-2020). Për ta zbatuar atë, Qeveria e Kosovës dhe ajo e Luksemburgut kanë nënshkruar një marrëveshje dypalëshe, me obligime dhe përgjegjësi për secilën palë. Sipas raportit të ZKA-së, Qeveria e Luksemburgut do t'i kryente obligimet e saj financiare për implementimin e projektit në vlerë prej 6.5 milionë eurosh, ndërsa Qeveria e Republikës së Kosovës do ta mbështeste dhe monitoronte zbatimin e projektit dhe do ta siguronte kontributin e saj në vlerë prej 1.3 milion eurosh. "Radio Evropa e Lirë" e pyeti Ministrinë e Shëndetësisë se sa para janë shpenzuar për projektin e nisur, por deri në publikimin e këtij shkrimi nuk mori përgjigje.

Ambasadori Rohde përgëzon vendimin për ndalimin e pirjes së duhanit në ambientet e mbyllura

PRISHTINË, 17 PRILL - Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde, ka përgëzuar vendimin e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit

Rural për zbatimin e Ligjit Kundër Duhanit. Sipas këtij vendimi, është e ndaluar të pihet duhani në ambiente të mbyllura. "Lajm i mirë që ministri

Peci ka filluar t'i zbatojë rregulloret ekzistuese të ndalimit të duhanit në restorante, bare etj. përmes inspektimeve të rrepta të pajtueshmërisë. Ushqimi

dhe birra janë shumë më të mira pa duhan rreth jush dhe shumë më të shëndetshme për të gjithë ne", ka shkruar Rohde në "Twitter".



Kaloi gjysma e mandatit qeverisës dhe asnjë shenjë nuk e bëri në ekonomi qeveria e “punësimit dhe drejtësisë”



Shkruan: Avdullah HOTI

Kaloi gjysma e mandatit qeverisës dhe asnjë shenjë nuk e bëri në ekonomi qeveria e “punësimit dhe drejtësisë”. Viti 2022 u përshkua me mungesë të qeverisjes efektive, e cila do t'i mbronte qytetarët nga inflacioni dhe do të promovonte zhvillim ekonomik. Parashikimi për vitin 2023 po ashtu nuk është më i mirë.

1. Rritja ekonomike më 2022 prej 3.5 për qind erdhi nga rritja e konsumit privat dhe eksporteve, e jo nga investimet publike apo

private. Në fakt, më 2022 bruto investimet kapitale kanë rënë për -6.9 për qind dhe konsumi qeveritar ra për -0.8 për qind, duke ndikuar negativisht në rritjen ekonomike.

2. Inflacioni, i cili arriti kulmin në 14.2 për qind në korrik 2022, erdhi si rezultat i rritjes të kostos së transportit, çmimit të energjisë dhe çmimit të ushqimeve. Situata nuk u menaxhua si duhet nga qeveria pasi ngarkesat tatimore mbetën të pandryshuara. Jo vetëm që nuk e suspendoi akcizën

në naftë për një kohë, por qeveria nuk e uli as TVSh-në nga 18 për qind në 8 për qind për disa artikuj ushqimor shtesë, edhe pse këtë ia mundësonte ligjin për TVSh-në. Si rezultat, qeveria mblodhi qindra miliona euro TVSh nga rritja e çmimeve të naftës, energjisë dhe ushqimeve. Për pasojë, bilanci bankar i qeverisë gjatë vitit 2022 ishte tepër i lartë. Pasi ato mjete nuk u shpenzuan në investime kapitale, ato u zhvlerësuan nga inflacioni.

3. Eksportet u rritën me 27 për

qind, por për shkak të bazës së ulët nuk kishin efekt të ndjeshëm në uljen e deficitit tregtar. Në anën tjetër, importet u rritën me 22 për qind, dhe për shkak të madhësisë së tyre, deficitit tregtar u thellua edhe për 1 miliardë euro. Kjo është indikative se në tregun vendor ende nuk ka rritje substanciale të prodhimit vendor, siç trumbetohet nga qeveritarët.

4. Edhe ato pak investime që ndodhën gjatë vitit 2022 ishin kryesisht në ndërtimtarë dhe si rezultat, kishin efekt shumë të

kufizuar në produktivitet dhe rritje ekonomike.

5. Deficiti buxhetor ra ndjeshëm, por kjo ishte si rezultat i dy faktorëve: (i) të hyrave shtesë që erdhën nga rritja e çmimeve pasi normat tatimore mbetën të pandryshuara, si dhe (ii) nënshpenzimit të ndjeshëm në investime kapitale publike, të cilat kanë qenë rekord të ulëta.

6. Të ardhurat reale ranë dhe standardi i jetës u përkeqësua për shkak të inflacionit dhe mungesës së masave adekuate qeveritare. Në vend që të ruhej fuqia blerëse e të ardhurave për të gjithë qytetarët përmes indeksimit të pagave e pensione në sektorin publik dhe pagës minimale në sektorin privat për normën e inflacionit, intervenimet e qeverisë u fokusuan në pako emergjente të natyrës sociale. Edhe pse këto intervenime ndihmuan grupe të caktuara të qytetarëve, ndihma ishte e njehershme dhe nuk e zgjodhi problemin e rënies së të ardhurave reale gjatë vitit 2022 për familjet në përgjithësi.

7. Në vitin 2023, rritja ekonomike pritet të jetë rreth 3.7 për qind, që është pothuajse e njëjtë me atë të vitit 2022. Shpresa këtu mbetet tek stabilizimi i çmimeve në tregje ndërkombëtare. Nuk shihet në horizont ndonjë politikë ekonomike që mund të krijojë ndonjë moment të ri për t'i dhënë shtytje zhvillimit dhe punësimit në vitin 2023 dhe 2024.

Ministri Peci viziton fermerët Gazmend dhe Ridvan Emini, i përgëzon për punën që po bëjnë

PRISHTINË, 17 PRILL - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, gjatë ditës vizitoi fermerët Gazmend dhe Ridvan Emini nga fshati Ribar i Vogël i komunës së Lipjanit, të cilët konsiderohen shembull pozitiv i kontributit për atdheun, pasi gjithë investimin nga puna në mërgim e kanë investuar në Kosovë, duke ngritur fermën në të cilën mbarëshojnë e rritin nga 150 deri në 400 viça për majmëri. Ministri i BPZHR-së, Faton Peci, i përgëzoi vëllezërit Emini për punën dhe kontributin e tyre dhe i njoftoi me risitë e Programit për Pagesa Direkte për këtë vit, duke thënë: “Programi për Pagesa Direkte/Subvencione 2023 përmes Udhëzimit Administrativ

qartëson dedikimin e këtyre mjeteve financiare për bujqit që punojnë tokën, edhe në rastet kur atë tokë e marrin me qira. Mbështetja financiare është e dedikuar për bujqit që investojnë djersë e mund e jo për pronarët e tokave/qiradhënësit”, theksoi ministri Peci.

Ajo çka i veçon Gazmendin e Ridvanin në këtë aktivitet blegtor është vendimi që së bashku të kthehen nga Zvicra e të investojnë në vendlindje me një infrastrukturë të kompletuar bujqësore, në stallë moderne sipas standardeve dhe mekanizëm bujqësor. Krahas aktiviteteve në fermë, ata kultivojnë rreth 100 hektarë me grurë dhe misër.



Murati fajëson LDK-në që qytetarët po paguajnë më shtrenjtë vajin dhe bukën



PRISHTINË, 17 PRILL - Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka thënë se çmimet e importit për vaj dhe grurë

kanë rënë. “Çmimi i furnizimit nga importi për vaj ushqimor ka rënë në 1.05 euro/litër. Çmimi i furnizimit nga importi për

grurë ka rënë në 0.24 euro/kg. Ligjin për çmimet tavan LDK-ja e dërgoi në Gjykatë Kushtetuese, prandaj qytetarët

vazhdojnë të paguajnë më shtrenjtë se që do të duhej për vaj, miell e bukë”, ka shkruar Murati në “Facebook”.

HEROI I KOMBIT ALBAN AJETI ME VETËDIJE TË LARTË IU BASHKUA RADHËVE TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS



Ismet SYLEJMANI

Shumë të dashur familjarë të Heroit të Kombit Alban Ajeti, Babë Sheqiri, Vëlla Petriti, mbesë Albana, nipa Albani e Nili dhe bashkëshorte e Petritit zonja Nebahate!
 Të dashura familje të Heronjëve e Dëshmorëve të Kombit!
 I dashur Kryekomandant Ali Ahmeti!
 I dashur Kryeministër i Kosovës Albin Kurti!
 I nderuar Zv. Kryeministri i Parë i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut Artan Grubi!
 I nderuar Kryetar i Senatit e ish-Rektor i Universitetit të Tetovës Vullnet Ahmeti!
 I nderuar Rektor i Universitetit të Tetovës Kushtrim Ahmeti!
 I nderuar Komandant i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Gjeneral Lejtnant Bashkim Jashari!
 I nderuar Drejtori Gjeneral i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha!
 I nderuar ish – Zv. Komandant i ZOK-ut të UÇK-së e Zv. Ministër i Mbrojtjes të Kosovës Shemsi Sylaj!
 I nderuar Kryetar i Komunës së Tetovës Bilall Kasami!
 I nderuar Kryetar i Komunës së Gjilanit Alban Hyseni!
 I nderuar Kryetar i Kuvendit të Gjilanit Arianit Sadiku!
 I nderuar Deputet i Parlamentit të Kosovës Luan Aliu!
 Të dashur student, studente e profesor të UT-së e të Universitetit "Kadri Zeka" nga Gjilani!
 Të nderuar të pranishëm!
 Zonja dhe zotrinjë!



Jemi tubuar sot për të nderuar Heroin e Kombit Alban Ajeti!

Kam nderin e madh dhe historik, që sot përpara juve në nderim të nderimit të madh që po i bëni Universiteti i Tetovës studentit të tij, duke e shpallur Hero të Universitetit të Tetovës, të shpalo biografinë e studentit Hero të UT-së, të luftëtarit të lirisë, bashkëluftëtarit tim, Heroit të Kombit Alban Ajeti!

Alban Ajeti u lind më 5 Shtator në 1978 në Lagjen Dardania 2 (ish-Gavrani) Rruga nr 18 në Gjilan! Më 1 Shtator të vitit 1985 ulet në

bankat e shkollës fillore dhe fillon shkollimin e Tij!
 Shkollën fillore e përfundoi në Selami Hallaçi dhe të mesmen e kreu në Zenel Hajdini në Gjilan, ndërsa studimet i vazhdoi në Fakultetin e Mjekësisë- Dega e Farmacisë në Universitetin e Tetovës, këtu në Tetovë, në vitin shkollor 1997/1998!
 Albani për dallim nga bashkëmoshatarët e tij, ishte i gjithanshëm, kishte prije në sport, por më së shumti ishte për mjeksi, ku edhe u regjistrua këtu në Tetovë!
 Albani la trashëgim shumë poezi

të cilat pas luftës në vitin 2002 iu botaan thjeshtë, në një përmbledhje të veçantë, me titull "Pranvera e Lirisë"!
 Poeti i talentuar Heroi i Kombit Alban Ajeti shkroi poezi të shumta, unë përpara juve të nderuar të pranishëm po i përmendi vetëm disa tituj të poezive dhe po e lexoj njërin nga ato!
 Titujt e poezive të Alban Ajetit janë: NËNA, ADEM JASHARI, HAMËZ JASHARI, VDEKJA PËR ATDHE, TOKA KËRKON GJAKUN TONË, BEKIM BERISHËS-ABESË, BORXHI NDAJ ATDHEUT, GJAKU,

SIMBOLET E LIRISË(kushtuar Zahirit, Edmondit,Hakifit), KOSOVËN S'MUND TA ZHBËJË ASKUSH, LUFTIA, BASHKIMI, 17 JANARI SHQIPTAR, ARDIAN KRASNIQIT etj.
 Kjo është përmbledhja me poezi e Albanit, shumica e të cilave janë të shkruara këtu në Tetovë!
 Përpara juve të nderuar të pranishëm po e lexoj nje poezi të shkurtër të shkruar nga Heroi i Kombit e Heroi i UT-së Alban Ajeti!
 VDEKJA PËR ATDHE
 Asnjë vdekje nuk është e mirë
 Sa vdekja për Atdhe
 Vetëm atëherë dhembja është e

vogël
 Vetëm atëherë miqtë
 Do të presin me kokë lartë
 Dhe krenari kur vijnë për ngushëllime.
Tetovë, 13 Dhjetor 1997, ora 15:00!

Kjo poezi dhe shumë të tjera, dëshmojnë se Albani ishte i përcaktuar dhe shumë i vendosur që të vdiste për Atdhe!
 Pra shihet qartë, pa llupë, se Alban Ajeti ishte i dashuruar në vdekjen për Atdhe!
 Heroi i Kombit Alban Ajeti, nuk ishte i vetmi student nga UT që iu bashkua luftës për liri në radhët e

UÇK-së, por është i vetmi student i UT-së që ra në fushë të nderit të Kombit!
 Heroi i Kombit Alban Ajeti dha prova të cilat i vulosi me gjakun e Tij, se ishte bir i madh dhe i denjë e i lavdishëm i popullit shqiptar, sepse thirrjes për luftë të armatosur çlirimtare kundër Serbisë pushtuese, iu përgjigj flakë për flakë dhe erdhi si shqiponjë mali nga Universiteti i Tetovës në Kosovë, dhe veshi uniformën luftarake e u rreshtua në radhët e UÇK-së në Zonën Operative të Karadakut!
 Historia e jetës së Tij e shkruar nga Ai, dëshmon se Ai e dinte se në

luftë për liri edhe mund të vritesh, por Ai erdhi, i braktisi auditorët e UT-së duke i zëvendësuar me istikamet e UÇK-së!
 Në njësitet e armatosura të radhëve të UÇK-së, Alban Ajeti morri emrin luftarak Pëllumbi!
 Alban Ajeti nesër më 15 Prill 2023 i mbushë 24 vite, qysh kur zemra e tij ndali rrahjet!
 Në malet e Zhegovcit, në luftë frontale me ushtrinë dhe policinë pushtuese serbe, ra heroikisht bashkë me shokë a bashkëluftëtarë të tjerë!
 Albanin e morri lufta çlirimtare për lirinë e Atdheut, dhe e bëri të pavdekshëm, e bëri Hero të


Atdheut!
 Albani ashtu si edhe qindra dhe mijera Heronjë të tjerë e derdhi gjakun e tij në tokën e pushtuar të Atdheut e për çlirimin e saj nga zgjedha pushtuese serbe!
 Sot Heroi i Kombit Alban Ajeti do të shënohet në memorijen historike të UT-së si njëri prej studenteve më besnik të tij!
 Të nderuar të pranishëm!
 Me lejon ti drejtohem me disa rreshta e ta informoj Heroin e Kombit Alban Ajeti, me sa vijon:
 Shumë i dashur Alban, o Pëllumbi i lirisë, që je duke na shikuar nga qielli!
 Nëna Jote Hazirja, sot nuk është këtu në mesin tonë, në nderimin të UÇK-së e Zv. Ministri i Mbrojtjes të Kosovës Shemsi Sylaj!
 Për të nderuar Ty, ka ardhur Drejtori Gjeneral i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha!
 Për të nderuar Ty, nga Gjilani kanë ardhur Kryetari Alban Hyseni, bashkë me Kryetarin e Kuvendit Arianit Sadikun dhe deputetin e Parlamentit të Kosovës Luan Aliun!
 Jemi shumë që kemi ardhur këtu për të nderuar Ty i pavdekshmi ynë i madh, Heroi i Kombit Alban Ajeti!
 Lavdia Jote nga sot e përgjithmonë do të mbulohet edhe nga një flamur tjetër, nga flamuri i shenjtë dhe i shtrënjtë i Universitetit të Tetovës!
 Lavdi e përzjeshme Heroit të Kombit e Heroit të Universitetit të Tetovës Alban Ajeti!

Për të nderuar Ty, sot ka ardhur, njëri prej katërshes së madhe të udhëheqjes studentore të vitit 1997, asistuesit politik të UÇK-së Adem Demaçi dhe sot Kryeministër i Kosovës Albin Kurti!
 Për të nderuar Ty, sot ka ardhur Gjeneral Bashkim Jashari, pjestari i familjes legjendare Jashari të Prekazit heroik!
 Për të nderuar Ty, këtu sot me ne janë edhe Zv. Komandanti ZOK-ut të UÇK-së e Zv. Ministri i Mbrojtjes të Kosovës Shemsi Sylaj!
 Për të nderuar Ty, ka ardhur Drejtori Gjeneral i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha!
 Për të nderuar Ty, nga Gjilani kanë ardhur Kryetari Alban Hyseni, bashkë me Kryetarin e Kuvendit Arianit Sadikun dhe deputetin e Parlamentit të Kosovës Luan Aliun!
 Jemi shumë që kemi ardhur këtu për të nderuar Ty i pavdekshmi ynë i madh, Heroi i Kombit Alban Ajeti!
 Lavdia Jote nga sot e përgjithmonë do të mbulohet edhe nga një flamur tjetër, nga flamuri i shenjtë dhe i shtrënjtë i Universitetit të Tetovës!
 Lavdi e përzjeshme Heroit të Kombit e Heroit të Universitetit të Tetovës Alban Ajeti!

Faleminderit!
 Ismet Sylejmani
 Ish-Shef për Informim e Zëdhënës i Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së!
 Tetovë, 14 Prill 2023!



Idiotësia artificiale



Nga Slavoj ŽIŽEK

Nuk ka asgjë të re në lidhje me lajmin se "chatbots" janë në gjendje të zhvillojnë një bisedë në gjuhën natyrore, të kuptojnë qëllimin bazë të një përdoruesi, dhe të ofrojnë një përgjigje bazuar në rregullat dhe të dhënat e paracaktuara. Por kapaciteti i chatbot-ëve të tilla është rritur dramatikisht muajt e fundit, duke shkakuar panik në shumë qarqe.

Kohët e fundit është thënë shumëçka për chatbot-et. Midis të tjerash që ato paralajmërojnë fundin e eseve tradicionale që shkruajnë studentët. Por një çështje që kërkon vëmendje më të madhe, është mënyra se si duhet të reagojnë chatbot-et kur bashkëbiseduesit njerëzorë përdorin shprehje agresive, seksiste ose raciste për ta nxitur robotin të paraqesë në këmbimfantazitë e veta.

A duhet të programohet Inteligenca Artificiale (AI) që të përgjigjet në të njëjtin nivel me pyetjet që shtrohen? Nëse vendosim se është normale miratimi i një rregulloreje, atëherë duhet të përcaktojmë se deri ku duhet të shkojë censura. A do të ndalohen pozicionet politike që disa grupime i konsiderojnë "fyese"?

Po në lidhje me shprehjet e solidaritetit me palestinezët e Bregut Perëndimor, apo pretendimin se Izraeli është një shtet aparteid (term që ish-presidenti i SHBA Xhimi Karter

e vendosi dikur në titullin e një libri)? A do të bllokohen ato si "anti-semite"?

Por problemet nuk mbarojnë këtu. Siç paralajmëron artisti dhe shkrimtari Xhejms Bridëll, AI-të e reja "bazohen në përvetësimin në shumicë të kulturës ekzistuese" dhe besimi se ato janë "në fakt të ditura ose kuptimplota është i rrezikshëm". Prandaj, ne duhet të jemi shumë të kujdesshëm ndaj gjeneratorëve të rinj të imazhit bazuar tek AI.

"Në përpjekjen e tyre për të kuptuar dhe riprodhuar tërësinë e kulturës pamore njerëzore, ato duket se kanë rikrijuar edhe frikën tonë më të errët. Ndoshta kjo është vetëm një shenjë se këto sisteme janë vërtet shumë të afta për të përkëdhelur vetëdijen njerëzore, deri në tmerrin që fshihet në thellësi të ekzistencës tonë: frikën tonë nga fëlliqësia, vdekja dhe korrupsioni" – thekson më tej Bridëll.

Por sa e aftë është kjo lloj teknologjie në përafrimin me ndërgjegjen njerëzore? Kujtojmë rastin e barit që reklamoi kohët e fundit një pije speciale me termat e mëposhtëm: "Blini një birrë për 2 të tilla, dhe merrni një birrë të dytë absolutisht falas!". Për çdo njeri, kjo është padyshim një shaka.

Motoja e klasike "blej një, merr një falas" është riformuluar për t'u anuluar. Është një shprehje cinike që do të vlerësohet si e ndershme me synim shtimin e shitjeve. A do të merrte një chatbot ndonjë nga

këto? Në esenë e tij të vitit 1805 "Mbi formimin gradual të mendimeve në procesin e të folurit" (botuar për herë të parë pas vdekjes në 1878), poeti gjerman Hajrih Von Kleist përmbys mendimin e zakonshëm, sipas së cilit njeriu nuk duhet të hapë gojën për të folur nëse nuk ka një ide të qartë se çfarë të thotë.

"Prandaj, nëse një mendim shprehet në mënyrë të paqartë, atëherë nuk do të thotë aspak se ai është konceptuar në një mënyrë konfuze. Përkundrazi, ka të ngjarë që idetë që janë shprehur në mënyrën më konfuze, janë ato që janë menduar më qartë."

Marrëdhënia midis gjuhës dhe mendimit është tejet e ndërlikuar. Në një pasazh nga një nga fjalimet e Stalinit nga fillimi i viteve 1930, ai propozon masa radikale për të "zbuluar dhe luftuar pa mëshirë edhe ata që kundërshtojnë kolektivizimin vetëm në mendjet e tyre. Po, e theksoj sërish: Ne duhet të luftojmë edhe mendimet e njerëzve!".

Mund të supozohet me siguri se ky pasazh nuk ishte përgatitur paraprakisht. Por pasi uimprovizua aty për aty, Stalini u bë menjëherë i vetëdijshëm për atë që sapo kishte thënë. Dhe në vend se të kërkonte ndjesë, vendosi t'i përmbahej hiperbolës së tij. Siç tha më vonë Zhak Lakan, ky ishte një rast i së vërtetës që u shfaq befasisht përmes aktit të kumtimit. Luis Altuser identifikoi një dukuri të

ngjashme në ndërveprimin midis asaj çka pritet dhe befasisë. Por a mund ta bëjë këtë ndonjë chatbot? Problemi nuk është se chatbot-et janë makineri budallaqë; pro se ata nuk janë mjaftueshëm të tilla. Dhe as se janë naivë (i mungon ironia dhe refleksiviteti); por se nuk janë mjaftueshëm naivë (mungon kur naiviteti maskon mendjempreshtësinë). Pra rreziku i vërtetë, nuk është se njerëzit mund ta ngatërrojnë një chatbot për një person real; por se komunikimi me chatbot do t'i bëjë njerëzit realë të flasin si chatbot, duke i humbur të gjitha nuancat dhe ironinë, duke thënë me obsesion vetëm saktësisht atë që dikush mendon se dëshiron të thotë. Kur isha më i ri, një miku im shkoi te një psikoanalist për trajtim pas një përvoje traumatike. Ideja e tij mbi atë që presin psikoanalistët nga pacientët e tyre ishte një klishe. Ndaj ai e kaloi seancën e tij të parë duke rrëfyer gjëra rreme, se si e urrente babanë e tij dhe donte që ai të vdiste.

Reagimi i analistit ishte shumë i zgjuar: ai mbajti një qëndrim naiv "para-frojdian" dhe e qortoi mikun tim që nuk e respektonte babanë e tij ("Si mund të flasësh kështu për personin që të bëri ky që je?"). Ky naivitet i shtirur dërgoi një mesazh të qartë tek miku im: Unë nuk i besoj gjënjeshtrave tuaja.

A do të ishte në gjendje një chatbot ta kuptojë këtë nëntekst? Me shumë gjasa jo, sepse është si interpretimi i Rouan Uilliams për Princin

Mishkin tek romani "Idioti" i Dostojevskit. Sipas leximit standard, Mishkin, "idioti", është një njeri i shenjtë, "pozitivisht i mirë dhe i bukur", i cili zhytet në çmenduri nga brutalitetet dhe pasionet e ashpra të botës reale.

Por në rileximin radikal të Uilliams, Mishkin përfaqëson syrin e një stuhie: sado i mirë dhe i shenjtë, është ai që shkakton kërdinë dhe vdekjen që dëshmon, për shkak të rolit të tij në rrjetin kompleks të marrëdhënieve rreth tij. Pra Mishkin nuk është një njeri i thjeshtë dhe naiv.

Është lloji i tij i veçantë i mendjempreshtësisë që e bën atë të pavetëdijshëm për efektet e tij katastrofike mbi të tjerët. Ai është një person sipërfaqësor që flet tamam si një chatbot. "Mirësia" e tij qëndron në faktin se si një chatbot, ai reagon ndaj sfidave pa ironi, duke shfaqur zhgënjim pa asnjë refleksivitet, duke marrë gjithçka fjalë për fjalë, dhe duke u mbështetur mbi një ide-formim automatik të plotë mendor dhe jo autentik.

Për këtë arsye, chatbot-et e rinj do të shkojnë shumë mirë me ideologët e të gjitha shtresave, nga turma e sotme që zhvillon luftërat kulturore deri te nacionalistët e "MAGA" në SHBA, që preferojnë të qëndrojnë në gjumë.

Shënim: Slavoj Žižek, filozof sloven, drejtor i Institutit Birkbeck për Shkenca Humane në Universitetin e Londrës. / "Project Syndicate" – Bota.al

Si e parashikonin fundin e botës, filozofët dhe mitologjia e lashtë greke



Kohët e fundit vizionet tona mbi fundin e botës, kanë variuar nga kërcënimi i krizës klimatike dhe i luftës bërthamore, deri tek imagjinimi i skenarit kur ne njerëzit i nënshtrohemi dhe në fund zëvendësohemi nga robotët që operojnë përmes Inteligjencës Artificiale. Më herët ka pasur tregime biblike të engjëjve që derdhnin zorrët e tyre mbi Tokë, duke i kthyer detet në gjak. Por para tyre çfarë mendonin grekët e lashtë për fundin e botës? Për shumë grekë të lashtë, përfshirë filozofët Platonin dhe Aristotelin, bota nuk ka një fund, sepse ajo është ciklike. Platon besonte se të mbijetuarit do të rindërtonin gjithmonë jetën e tyre pas një katastrofe të madhe. Shumë

nga stoikët besonin tek Ekpirosis, shkatërrimi periodik i kozmosit – çdo 36.000 vjet sipas Platonit – përpara se të fillonte sërish një cikël i ri. Poeti grek, filozofi ekonomik, bashkëkohësi i Homerit, dhe kronikani i rastësishëm i historisë, Hesiodi, shkruanin për një lloj apokalipsi që do të ndodhte, ku Perënditë shkatërrojnë njerëzimin.

Pesë epokat e njeriut sipas mitologjisë greke

Në poemën epike “Veprat dhe ditët” (Viti 700 Para Erës Sonë), Hesiodi i ndau në 5 periudhat e historisë. Ato ishin Epoka e Artë, Epoka e Argjendte, Epoka e Bronzit, Epoka Heroike dhe Epoka e Hekurit, dhe e

përshkruan përparimin e njerëzimit përmes thjerrëzave të mitologjisë greke.

Epoka e Artë nisi menjëherë pasi “zotat e pavdekshëm që banojnë në Olimp, krijuan një racë të artë njerëzish të vdekshëm”. Pastaj erdhi një “brezi i dytë njerëzish, që ishte prej argjendi dhe më pak fisnik”. Ai u pasua nga Epoka e Bronzit, një brez i tretë që ishte “i tmerrshëm dhe i fortë” dhe i etur për dhunë.

“Ata e shkatërruan veten, kaluan në shtëpinë e lagësht të Hadesit të ftohtë, dhe nuk lanë pas ndonjë emër. Sado të tmerrshëm që ishin, Vdekja e zezë i mori, dhe kështu ata lanë dritën e ndritshme të diellit”- shkroi Hesiodi. Në disa versione të rrëfimit, Zeusi dërgon një përmytje për të

vrarë njerëzit e Epokës së Bronzit.


Pas kësaj, ai krijoi një “racë heronjsh të ngjashëm me Perëndinë”, dhe në këtë kohësupozohet se jetuan shumica e heronjve mitologjikë grekë përfshirë Perseun, Odiseun dhe Akilin. Hesiodi ankohej se nuk kishte lindur në Epokën e Heronjve, por në epokën tjetër.

“Sepse tani është Epoka e Hekurit, ku njerëzit nuk pushojnë kurrë së punuari fort ditën dhe u trishtuar natën; dhe Perënditë do t’i vënë në telashe të rënda”. Hesiodi besonte se kjo epokë “e hidhur” dhe “mizore” do të ishte e fundit.

“Sidoqoftë, edhe këta do të kenë disa të mira të përziera me të këqijat e tyre. Dhe Zeusi do ta

shkatërrojë këtë racë njerëzish të vdekshëm edhe kur ata t’i kenë flokë e thinjur”- shtoi ai më tej. Hesiodi përshkruan më shumë detaje rreth kësaj epoke, duke e parë atë si një kohë kur keqbërësit lavdërohen për veprat e tyre të dhunshme dhe kur njerëzimi kënaqet me të keqen. “Dhe atëherë Aidos dhe Nemesis, me format e tyre të ëmbla dhe të mbështjella me rroba të bardha, do të largohen nga toka, dhe do të braktisin njerëzimin për t’u bashkuar me shoqërinë e Perëndive të pavdekshme. Dhe pikëllime të hidhura do t’u lihen njerëzve të vdekshëm, teksa nuk do të ketë asnjë ndihmë kundër të keqes”. Shpresojmë që bota të jetë ciklike, sepse nuk do të donim që të merrte fund njëherë e përgjithmonë.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



FFK-ja për vizitën e zyrtarëve të UEFA-s dhe të FIFA-s: U diskutua vetëm për licencim

PRISHTINË, 17 PRILL - Federata e Futbollit të Kosovës ka njoftuar për vizitën që ia bënë të hënën delegacioni i UEFA-s dhe ai i FIFA-s. Servet Yardimci, anëtar i Komitetit Ekzekutiv të UEFA-s dhe kryetar i Komitetit të UEFA-s për Federatat Kombëtare dhe Luca Nicola, kryesues i Qeverisjes Kombëtare dhe Institucioneve Globale të UEFA-s, si dhe Sofia Malizia, menaxhere e qeverisjes së federatave

anëtare të FIFA-s, qëndruan në Kosovë, për t'u njoftuar nga afër me zhvillimet e fundit rreth FFK-së, procesin e licencimit nga MKRS-ja dhe vështirësitë me të cilat po ballafaqohen klubet e futbollit. Siç njofton FFK-ja, delegacioni, që ka ardhur për një "vizitë të jashtëzakonshme", fillimisht u takua me nënkryetarin Bakir Burri dhe me sekretarin e përgjithshëm, Taulant Hodaj,

derisa më pas e zhvilluan një takim të përbashkët edhe me përfaqësuesit e disa prej klubeve, për t'i diskutuar shqetësimet e këtyre të fundit në lidhje me procesin e licencimit dhe vështirësitë që po i hasin gjatë këtij procesi. "Përfaqësuesit e UEFA-s dhe FIFA-s i dëgjuan me vëmendje të gjitha shqetësimet e ngritura nga përfaqësuesit e klubeve, premtuan se do t'i adresojnë ato në organet kompetente

dhe me angazhimin e përbashkët të të gjitha palëve shumë shpejt mund të ketë rezultate pozitive në këtë drejtim. Më pas delegacioni i UEFA-s dhe FIFA-s i vazhdoi takimet me akterët tjerë të sportit në Kosovë, po ashtu, në frymën e bashkëpunimit dhe konstruktivitetit", njofton shtëpia e futbollit kosovar. Pra, në këto takime u fol vetëm për çështjen e licencimit, por jo edhe për dërgimin në arrest



shtëpiak për një muaj të kryetarit të FFK-së, Agim Ademi, i cili dyshohet për veprat "Keqpërdorim i besimit" dhe "Shmangie nga takimi".

Thaqi largohet nga Drita, Josa favorit për pozitën e trajnerit

Arsim Thaqi edhe zyrtarisht të hënën është ndarë me klubin e Dritës, pasi ishte i pakënaqur me rezultatet në ndeshjet e fundit. Klubi gjilanas miratoi dorëheqjen e Thaqit dhe tash ka filluar punën për të gjetur pasardhësin e tij, derisa i pari në listë është Mirel Josa

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 17 PRILL - Bazimi në ndeshjen e fundit nga skuadra e Dritës në përballje me Dukagjinin e Klinës dhe humbja e pozitës së parë ka ndikuar që trajneri Arsim Thaqi të jep dorëheqje të parevokueshme nga posti i shefit të shtabit teknik në klubin gjilanas. Lajmin e ka konfirmuar skuadra e Dritës në faqen zyrtare në "Facebook". "I pa kënaqur me rezultatet e deritanishme, trajneri Thaqi kërkoi takim me

kryesin e klubit për ofruar dorëheqjen e tij. Pas shumë diskutimeve kryesia e klubit i ofroj trajnerit mbështetje për vazhdimin e rrugëtimit drejt synimit të klubit por që trajneri ishte i vendosur për këtë vendim dhe kryesia e klubit u detyrua ta respektoj vendimin e trajnerit Arsim Thaqi për të ja pranuar dorëheqjen", thuhet në njoftimin e Dritës. Ky klub e ka falënderuar trajnerin Thaqi për bashkëpunimin tejet korrekt dhe profesional dhe i ka dëshiruar shumë suksese në vazhdim të karrierës.



Menjëherë pas largimit të Thaqit nga posti i trajnerit, drejtuesit e klubit të Dritës kanë filluar të mendojnë për pasardhësin e tij. Gazeta ka mësuar se në krye të listës është

ish-trajneri i Prishtinës, Mirel Josa, derisa po ashtu në këtë listë janë edhe ish-trajneri Bekim Isufi dhe ish-futbollisti dhe ish-ndihmës trajneri Alban Dragusha. Aktualisht skuadra e

Dritës është në vendin e dytë me 57 pikë, një pikë më pak se skuadra e Ballkanit që është lidere. Drita nga 29 ndeshje ka regjistruar 16 fitore, 9 barazime dhe 4 humbje.

Ramadani, "Ylli i javës" në Superligë



PRISHTINË, 17 PRILL - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall vazhdojnë ndarjen e çmimit "Ylli i Javës". Ky çmim për javën e 29-të i ka takuar futbollistit të SC Gjilani, Arbnor Ramadani. Komisioni vendosi që epiteti i yllit të javës t'i takojë Arbnor Ramadani të SC Gjilani, ngase asistoi në dy golat e fitores së skuadrës së tij kundër Malishevës si mysafir (2:0). Ai u

vlërësua edhe për paraqitjen e mirë gjatë tërë ndeshjes në mesfushë dhe për kreativitetin që i dha lojës së gjilanasve. "Kjo është hera e dytë që shpallëm më i miri i javës dhe është një kënaqësi e vërtetë, sidomos tash në fund të kampionatit, kur secila lojë luftohet shumë, secila pikë është e rëndësishme dhe secili lojtar jep më shumë se 100% nga vetja. Për këtë çmim meritë kanë edhe

bashkëlojtarët, të cilët i falënderoj për punën dhe përkushtimin e madh në ndeshjen kundër Malishevës. Tani Gjilani është këndellur dhe jemi në rrugën e duhur për të siguruar daljen në garat evropiane. Na presin edhe 7 ndeshje të tjera shumë të rëndësishme, derisa shpresojmë të jemi edhe në finale të Kupës së Kosovës", ka theksuar Ramadani.

Ulpiana, kampione në Ligën e Parë në hendboll

GJILAN, 17 PRILL - Me fitoren në Gjilan ndaj Dritës, KHF Ulpiana ka kompletuar një edicion shumë të suksesshëm. Skuadra nga Lipjani ka fituar të gjitha 16 ndeshjet kampionale

dhe ka fituar titullin e kampionit në Ligën e Parë të Kosovës në hendboll. Në edicionin e ardhshëm garues, Ulpiana do të jetë pjesë e Superligës së Kosovës. Të

dielën, Ulpiana fitoi në Gjilan ndaj Dritës me rezultat 35:28. Alketa Baftijari i realizoi 12 gola, ndërsa tetë i kishte Ermira Krasniqi. Ulpiana kthehet në Superligë pas një

viti mungesë, por këtë herë me synime më të mëdha. Në Ligën e Parë ka lënë prapa KEK-un, Vjosën, Dritën, Trepçën, Prizrenin, Deçanin, CLICK-un dhe Llapushën.



THIRRJE PER APLIKIM (DHENJE TE OFERTES)

Emin I.Gerbeshi B.I. ME NR. UNIK 811120170 me seli ne Vushtrri fsh.Ropice

Pronar Emin Gerbeshi po kerkon nje oferte kontraktuese.

Kompani te interesuara dhe te kualifikuara qe te dorzoj nje ofere-te-propozim per mallra-punet sherbimetkeshilluese si ne vijim per Kompanit e interesuara per ofertim te ketyre Makinave dhe pajisjeve tjera bujqesore ,dhe energji solare.

1. Traktor Landini minimum 75 hp -90 hp , 4x4 me kabine ,klime , Me luge ngarkuese
2. Rimorkio Celmak 5 ton –kiper 3 anet ,frena hidrolik,kanata te dyfishta.
3. Freze Minos T-SR 2100
4. Shperndarse e plehut Fimaks 4T
5. Mikser Fimaks 3m3 me ngarkues hirdaulik
6. Lidhese bari Sipma
7. Energji Solare 3kw

Kompanit e interesuar duhet te kontaktojn direkt te Emin Gerbeshi BI

Nepermjet emailit apo telefonit per te kerkuar nje ftese per kuotim tek adresat me posht;

Afati per ftese per kutim- 5 dite nga data e publikimit

Afati per dorzim te ofertave 10 nga dita e pranimit te ofertave .

Ofertat duhen te dorzohen ne ne adresen e lart cekur (fshati Ropice Komuna Vushtrri)

Per informata shtese Ne nr. +38349332223 ,emingerbeshi@hotmail.com

Thirrje për aplikim

Organic Walnuts shpk – NUI 810164393, me adresë Mati 1 Rr. Raif Pollomi Bll C7 Nr.52, Prishtinë, po kërkon ofertues/kontraktor/kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë ofertë/propozim për: Ndërtimi i depos 204m², Linjë për përpunim, klasifikim, tharje, ruajtje, largimin e mbetjeve me dridhje, klasifikim dhe kalibrim, rripa transportuese etj. të arrës dhe Panele solare - energji e ripërtëritshme 3.5kw.

Nr. Prokurimit 2023-1

Emri: Gresa Dreshaj - Organic Walnuts shpk
Të interesuarit për aplikim dosjen me specifika mund ta kërkojnë përmes e-mailit: gre-sadreshaj@gmail.com

Adresa: Mati 1 Rr. Raif Pollomi Bll C7 Nr.52, Prishtinë

Ofertat duhen dorëzuar më së largu 10 ditë nga dita e publikimit ne gazetë të thirrjes, ora 15:00, në adresën e kompanisë.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Visar Qenaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Bajram Curi " Romaje.

- Beko Meta shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Izvor " Lubinje e Epërme.

- Sadete Musa nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës fillore "Jahë Salihu" Molliq KK Gjakovë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



PASHTETË PULE

MEKA
HALAL FOOD

gluten
free



100% mish pule



cilësi e garantuar

pa konservues